

Përshkrimi i punës – Kordinator Biznesi për Rajonin e Fierit

Punëdhënësi: CBS Creative Business Solutions

Vendndodhja: Fier

Statusi: Me kohë të plotë

Mbi Pozicionin

Kordinatori i Biznesit zhvillon dhe menaxhon me profesionalizem një portofol klientësh duke i mbështetur me konsulence të vazhdueshme në procesin e financimit nga bankat, institucionet financiare apo programe donatore me fokus në investimet e reja. Ai/ajo është përgjegjës për rritjen e portofolit të financimit të klientëve nëpërmjet aplikimeve të sukseshme për kredi, granteve të IPARD-it, skemave të garancisë dhe formave të tjera alternative për rritjen e kapitalit. Gjithashtu, Kordinatori i Biznesit asiston sipërmarrësit me përgatitjen e planeve të biznesit dhe adaptimit të praktikave të nevojshme bashkëkohore për zhvillimin e biznesit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Zhvillon portofolin e klientëve nëpërmjet aplikimeve për kredi, planeve të biznesit, këshillimit financiar, asistencës teknike dhe mbështetjes me kapitale;
- Përgjegjës për performancë të sukseshme në arritjen e targetit të portofolit me klientët e financiar;
- Zhvillon marrëdhënie të sukseshme me ekipin rajonal të bankave partnere duke arritur aplikime kredie me kualitet të lartë dhe disbursime të sukseshme;
- Ndërton marrëdhënie të sukseshme me ekipin rajonal të drejtorive bujqësore duke arritur aplikime të sukseshme për klientet me grantet IPARD dhe skemat e AZHBR;
- Zhvillon dhe mirëmban rrjetin e klientëve rajonale me potencial në financime dhe rritje kapitalesh;
- Përgjegjës për zhvillimin e biznesit të ri dhe prezantimin e CBS dhe projektit Smartkapital në të gjitha ngjarjet rajonale;
- Është përgjegjës për realizimin e targeteve në rajonin që mbulon;
- Ka për detyrë të menaxhojë burimet njerëzore/stafin e dedikuar në rajonin që operon;
- Të krijojë kontakte me biznesin dhe partnerët që operojnë në rajonin që mbulon;
- I raporton Menaxherit të Shërbimeve të Agrobiznesit/ Menaxherit të Financimeve të Agrobiznesit.

Kualifikimi

- Eksperiencë profesionale prej minimum 5 vjetësh me një institucion financiar ose organizate konsulente te specializuar në financimin e bujqësisë;
- Eksperiencë me përgatitjen e aplikimeve për kredi dhe pasqyrave financiare. Aftësi analitike në përgatitjen e rekomandimeve financiare dhe planeve të biznesit;
- Aftësi bindëse komunikimi me klientët dhe kompetencë në komunikimin me shkrim;
- I/e aftë të punojë në mënyrë të pavarur, duke arritur disa objektiva dhe performancë të lartë brenda afatit kohor. Aftësi të larta organizimi;
- Motivim i lartë profesional me angazhim të standarteve të larta etike.

Si Të Aplikoni:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një letër të shkurtër interesi dhe CV-në e tyre përpara datës 13 Nentor 2019 në adresën: info@cbs.al dhe në subjektin e e-mailit të shkruajnë "Koordinator Biznesi".

Rreth CBS

Creative Business Solutions (CBS) është një organizatë për zhvillim ekonomik me përvojë në konsulencë dhe në zbatimin e projekteve në fushat e Financës, Bujqësisë, Turizmit, Energjisë së Gjelbër e të tjerë. CBS është partnere e shumë donatorëve ndërkombëtarë për zbatimin e projekteve të zhvillimit në fushat e financës, turizmit dhe bujqësisë. CBS punon ngushtë me partnerë të kualifikuar për zhvillimin e produkteve të orientuara drejt teknologjisë ku përfshihet: IntoAlbania.com, IntoAlbania app, Agroweb.org, LORES, AGIS etj. Që nga themelimi i organizatës në vitin 2013, CBS ka zbatuar 21 projekte zhvillimi me një buxhet të kombinuar që arrin në \$7.8 milion. CBS ka një ekip prej më shumë se 45 profesionistë në zyrën qendrore në Tiranë dhe në tre degët rajonale në, Fier, Korçë dhe Peshkopi.

www.cbs.al

